# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8324
E hënë, 22 qershor 2026
Çmimi 0. 50 €


## Trumpi kërcënon Teheranin, ShBA-ja dhe Irani zhvillojnë bisedime në Zvicër

FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# PSE SHKURTIMI I TRUPAVE TË KFOR-it SHKON PËRTEJ ÇËSHTJES USHTARAKE?

FAQE 4-5



Shkurtimi i paralajmëruar i trupave të KFOR-it në Kosovë është paraqitur si pasqyrim i një situate më të qëndrueshme të sigurisë në terren. Por, përtej këtij interpretimi zyrtar, ky zhvillim ngre pyetje për të ardhmen e sigurisë, rolin e institucioneve vendore dhe balancat politike brenda dhe jashtë vendit



## HARADINAJ: NËSE OPOZITA MË PROPOZON, DO TA SHQYRTOJA KANDIDATURËN PËR PRESIDENT

F. 3

## MABCO RIKTHEHET NË KANTIER, PACOLLI PARALAJMËRON VAZHDIMIN E PUNIMEVE NË AEROPORTIN E VLORËS

F. 6



## AKTUALE



### 'NUK E KANË INFORMUAR MJAFTUESHËM PUBLIKUN', THOTË BLAKAJ PËR DHOMAT E SPECIALIZUARA

F. 3

### RAMADANI: JOSTABILITETI INSTITUCIONAL RREZIKON SIGURINË KOMBËTARE TË KOSOVËS

F. 3

### PROTESTAT NË TIRANË, RAMA: LËRENI ALBIN KURTIN JASHTË KËSAJ ÇORBE TË NEVERITSHME

F. 6

## EKONOMI



### EKONOMISTËT THONË SE INFLACIONI I LARTË PO RËNDON BIZNESET DHE PO VARFËRON QYTETARËT

F. 7

### KURTI: DO TA NISIM PROGRAMIN 'SUPERPUNA PËR GRATË', GARANTON PAGËN MINIMALE PËR GJASHTË MUAJ

F. 7

## SPORT




### PANAIRI NË PRANGA

F. 11

Shkruan: Berat ARMAGEDONI


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# TRUMPI KËRCËNON TEHERANIN, SHBA-ja DHE IRANI ZHVILLOJNË BISEDIME NË ZVICËR

UASHINGTON, 21 QERSHOR - Presidenti amerikan, Donald Trump, kërcënoi se do ta godasë Iranin "shumë ashpër sërish" për shkak të "aleatëve" të tij në Liban, teksa bisedimet e nivelit të lartë po zhvillohen mes nënpresidentit amerikan JD Vance dhe përfaqësuesve iranianë në resortin Burgenstok të Zvicrës më 21 qershor. "Irani duhet menjëherë t'i ndalë aleatët në Liban nga shkaktimi i telasheve", shkroi Trump në medie sociale, duke iu referuar Hezbollahut të mbështetur nga Irani, i cili ka këmbyer zjarr me Izraelin. "Nëse ata nuk e bëjnë, Irani do të goditet sërish ashpër, sikurse e goditëm javën e kaluar, por kësaj radhe më ashpër", shkroi presidenti amerikan.

Hezbollahu është edhe grup militant dhe parti politike që kontrollon shumicën e jugut të Libanit. Ai konsiderohet organizatë terroriste nga ShBA-ja, ndërkaq Bashkimi Evropian ka në listë të zezë vetëm krahun ushtarak të tij.

As Izraeli, as Libani nuk janë të përfaqësuar drejtpërdrejt në bisedimet në Zvicër, të cilat synojnë finalizimin e një memorandumi mirëkuptimi për t'i dhënë fund luftës mes ShBA-së dhe Iranit që filloi gati katër muaj më parë dhe për ta rihapur Ngushticën e Hormuzit.

Postimi i Trumpit erdhi pak pas deklaratës së Vances, i cili i cilësoi bisedimet në Zvicër si "një takim historik", duke thënë se qëllimi ishte "të hapim një faqe të re për t'i transformuar marrëdhëniet tona me popullin e Iranit dhe ta shtrijmë dorën e bashkëpunimit". "Përjashto muajt e fundit, kurrë më parë udhëheqjet iraniane dhe amerikane nuk janë takuar në një nivel kaq të lartë", tha Vance gjatë bisedimeve.

Ai shtoi se negociatorët amerikanë ndodhen në Zvicër që "përmes diplomacisë, përmes bashkëpunimit, të transformojnë Lindjen e Mesme, ku Irani dhe vendet e Gjirit kanë qenë në luftë me njëri-tjetrin". "Ne shohim një të ardhme ku të gjithë mund të punojnë së bashku për të promovuar paqe dhe prosperitet për të gjithë", shtoi ai.

Koha është kritike. Armëpushimi Izrael - Liban, që u arrit dy ditë më parë, veçse është nën presion të dukshëm. Autoritetet libaneze thanë se sulmet izraelite kanë vrarë 67 persona gjatë 48 orëve të fundit, ndërkaq sulmet e Hezbollahut kanë vrarë të paktën pesë ushtarë izraelitë. Që atëherë, Izraeli ka ndaluar operacionet, por kryeministri Benjamin Netanyahu është zotuar se do të hakmerret ndaj çdo kërcënimi të ri.

Hezbollahu është edhe grup militant edhe parti politike që kontrollon shumicën e jugut të Libanit. Ai konsiderohet organizatë terroriste nga ShBA-ja, ndërkaq Bashkimi Evropian ka në listë të zezë vetëm krahun ushtarak të tij. Kjo rrit mundësinë që edhe teksa Uashingtoni dhe Teherani negociojnë, përshkallëzimi rajonal mund të minojë procesin diplomatik.

Ngushtica e Hormuzit mbetet një tjetër pikë kyçe e përplasjes. Zyrtarët amerikanë dhe iranianë vazhdojnë të mos bien dakord nëse kjo rrugë detare - jetike për tregjet globale të energjisë - është plotësisht e hapur, një mosmarrëveshje që analistët thonë se Teherani mund ta përdorë si levë gjatë bisedimeve. "Është një kartë që iranianët ka gjasa ta luajnë vazhdimisht", tha një analist rajonal që është i afërt me negociatat.

Megjithatë, zyrtarët që kanë mbërritur në Lucernë po sinjalizojnë optimizëm të kujdesshëm. Si Uashingtoni ashtu edhe Teherani janë akuzuar për shkelje të elementeve të armëpushimit, por diplomatët thonë se të dyja palët ruajnë interes të fortë për ta shmangur rikthimin në luftë në shkallë të plotë. "Ky është vetëm fillimi", tha një zyrtar i lartë amerikan për Radion Evropa e Lirë. "Mos harroni, na kanë mbetur edhe 58 ditë."

Ky afat - pjesa e mbetur e periudhës 60-ditore të zbatimit - mund të përcaktojë nëse bisedimet në Lucernë shndërrohen në një rikonfigurim më të gjerë rajonal ose dështojnë në dritë të realiteteve të pazgjidhura në fushëbetejë.

Përpjekja e ripërtërirë diplomatike erdhi pas ndërhyrjes urgjente të zyrtarëve nga Zvicra dhe Katari, pasi pasiguria rreth pjesëmarrjes së Iranit kishte shkaktuar përkohësisht ndërprerje të takimeve një ditë më parë.

Këshilltari federal zviceran Ignazio Cassis zhvilloi konsultime me kryeministrin e Katarit, Mohammed bin Abdulrahman bin Jassim Al Thani, në Burgenstok, teksa Radio Evropa e Lirë mësoi se ndërmjetësues pakistanezë dhe ndihmës të lartë nga Uashingtoni dhe Teherani u përfshinë gjithashtu në përpjekjet për ta shpëtuar procesin.

Më 20 qershor, ekspertët teknikë kishin rifilluar takimet përgatitore në resortin zviceran, ndërsa Zvicra konfirmoi publikisht se bisedimet ishin aktive. "Zvicra vazhdon të ofrojë një mjedis diskret dhe të besueshëm për t'i lehtësuar bisedimet në Burgenstok mbi zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet ShBA-së dhe Iranit", tha qeveria zvicerane, duke refuzuar të japë hollësi të tjera.



Më vonë, si Uashingtoni ashtu edhe Teherani konfirmuan se negociatorët e tyre do të udhëtonin drejt Zvicrës.

### Bisedimet rinisin nën presion

Mbrëmjen e 20 qershorit delegacioni i nivelit të lartë i Iranit arriti në Cyrih. Ekipi udhëhiqet nga kryetari i Parlamentit iranian, Mohammad Bagher Ghalibaf, dhe përfshin ministrin e Jashtëm, Abbas Araghchi, zëdhënësin e Ministrisë së Jashtme, Esmaeil Baghaei, si dhe zyrtarë të lartë të sektorëve bankarë dhe të naftës, duke vënë në pah se lehtësimi i sanksioneve dhe rimëkëmbja ekonomike mbeten në qendër të llogaritjeve të Teheranit.

Nga ana amerikane, nënpresidenti JD Vance është në Zvicër, duke iu bashkuar të dërguarit të posaçëm Steve Witkoff dhe këshilltarit presidencial Jared Kushner, të cilët veçse ndodheshin në terren duke punuar mbi detajet teknike të negociatave.

Duke folur me gazetarët përpara nisjes nga baza ajrore Andrews më 20 qershor, nënpresidenti amerikan Vance tha se bisedimet do të përqendrohen në dy prioritete: programin bërthamor të Iranit dhe stabilizimin e Libanit. "Mendoj se shpresojmë të bëjmë përparim në çështjen bërthamore dhe të bëjmë përparim në çështjen e armëpushimit në Liban. Këto janë dy çështjet kryesore te të cilat besoj se do të përqendrohemi", tha Vance.

Ai shtoi se pret që negociatat të zgjasin "disa ditë".

Deklaratat e tij vënë në pah se sa ngushtë është ndërlidhur fronti i Libanit - dhe përballja e Izraelit me Hezbollahun - me procesin më të gjerë diplomatik ndërmjet ShBA-së dhe Iranit.

### Libani mbetet pika kyçe e mosmarrëveshjeve

Victor J. Willi, drejtor ekzekutiv i Institutit e Zvicrës për Lindjen e Mesme, tha se vetë fakti që bisedimet rifilluan pas ndërprerjeve tregon një realitet themelor strategjik: si Uashingtoni, ashtu edhe Teherani duan t'i japin fund luftës, që nisi në fund të shkurtit. "Unë mendoj se administrata e [presidentit amerikan Donald] Trumpit është serioze në përpjekjen për të dalë nga kjo luftë", tha Willi në një intervistë për Radion Evropa e Lirë. "Nuk është një luftë popullore. Ajo e dëmton Trumpin. Potencialisht mund ta dëmtojë edhe në zgjedhjet e mesmandatit".

Ai tha se edhe Teherani duket po aq i motivuar për t'i dhënë fund luftës. "Mendoj, gjithashtu, se iranianët duan të dalin nga kjo luftë". Megjithatë, Willi paralajmëroi se struktura e çdo marrëveshjeje mbetet e brishtë për shkak të asaj që ai e quajti "çështja libaneze". "Çështja kyçe është Libani. Çështja kyçe është Izraeli", tha ai. Sipas tij, Teherani tani po teston në mënyrë efektive nëse Uashingtoni është i gatshëm - dhe i aftë - t'i frenojë operacionet ushtarake izraelite mjaftueshëm sa për ta ruajtur kornizën më të gjerë të paqes.

Ky vlerësim përputhet ngushtë me deklaratat e nënpresidentit amerikan JD Vance. I pyetur nëse rifillimi i luftimeve në Liban mund ta pengonte procesin diplomatik, Vance këmbënguli se situata po përmirësohej. "Në fakt, gjërat po përmirësohen atje dhe po qetësohen disi", tha Vance duke shtuar se armëpushimi do të kërkojë menaxhim dhe mbikëqyrje të vazhdueshme.

Për Willin, kjo mbivendosje e çështjeve është e rëndësishme, sepse sugjeron se të dyja palët e kuptojnë që Libani mund të jetë faktori më i menjëhershëm që do të përcaktojë nëse afati 60-ditor për zbatimin e marrëveshjes do të mbijetojë. Ai, po ashtu, paralajmëroi se politika e brendshme në Izrael mund ta ndërlikojë procesin. "Brenda Izraelit ekziston mbështetje e gjerë. Izraelitët duan që regjimi iranian të largohet" nga pushteti, tha Willi. Sipas tij, kjo krijon ato që ai e përshkroi si realitete politike konkurruese – një në Uashington, një në Teheran dhe një tjetër në Jerusalem – të cilat mund të mos përputhen lehtësisht me njëra-tjetrën.

Bisedimet teknike pritet të përqendrohen po në rikthimin e inspektimeve nga Agjencia Ndërkombëtare për Energji Bërthamore (IAEA) në objektet bërthamore të Iranit, përfshirë në centralin për pasurim të karburantit në Fordo, në centralin bërthamor të Natanzit dhe në qendrën për teknologji bërthamore të Isfahanit.

Një qasje e tillë do të shënonte rikthimin e parë të inspektorëve që nga lufta 12-ditore e qershorit 2025.

Në këmbim, Uashingtoni është i gatshëm të lirojë disa miliardë dollarë nga asetet iraniane që janë të ngrira në Katar, të cilat do të përdoreshin për blerje për çështje humanitare, përfshirë ushqime dhe ilaçe. Sipas Willit, kjo shtresë teknike e negociatave mund të përcaktojë në fund nëse memorandumi do të shndërrohet në një marrëveshje të mirëfilltë. "Nëse duhet të ketë një përfundim të besueshëm të programit bërthamor, duhet të ekzistojë një regjim inspektimi", tha ai. Ai paralajmëroi se memorandumi i nënshkruar nga udhëheqësit e ShBA-së dhe Iranit në fillim të javës mbetet vetëm një kornizë e gjerë politike.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# "NUK E KANË INFORMUAR MJAFTUESHËM PUBLIKUN", THOTË BLAKAJ PËR DHOMAT E SPECIALIZUARA


Eva Plevier (Reuters)

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Drejtori i Fondit për të Drejtën Humanitare, Bekim Blakaj, ka kritikuar nivelin e transparencës së Dhomave të Specializuara të Kosovës. I ftuar në emisionin "Info Magazine" në Klan Kosova, Blakaj tha se këto institucione nuk kanë bërë mjaftueshëm për informim dhe ndërgjegjësim të publikut lidhur me proceset që po zhvillohen. "Sigurisht, ndoshta pak ky raport e ka ngritur vetëdijen sidomos sa i përket transparencës së Dhomave të Specializuara të Kosovës. Transparenca nuk ka ekzistuar ashtu siç e kemi pritur, ka pasur komunikime të ndryshme përmes komunikatave, videomesazheve, mirëpo Dhomat e Specializuara të Kosovës, ashtu siç përmendet edhe në raport, është një gjykatë e krijuar nga Kosova dhe ata do të ishin, do të duhej të ishin, shumë më transparentë dhe të vendosnin një lloj bashkëpunimi jo vetëm me institucionet e Kosovës, por ndoshta edhe me shoqërinë në tërësi. Diçka që është shumë e rëndësishme është që Dhomat e Specializuara, edhe pse e kanë një program të informimit dhe ndërgjegjësimit, nuk kanë bërë mjaftueshëm që publiku në Kosovë të kuptojë se çfarë po ndodh atje", tha Blakaj në Klan Kosova.

# RAMADANI: JOSTABILITETI INSTITUCIONAL RREZIKON SIGURINË KOMBËTARE TË KOSOVËS

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Eksperti i sigurisë, Burim Ramadani, ka vlerësuar se Kosova vazhdon të përballet me sfida dhe rreziqe të ndryshme në fushën e sigurisë kombëtare, ndërsa ka theksuar nevojën për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe NATO-s. "Kosova edhe më tutje vazhdon të përballet me sfida dhe rreziqe të ndryshme të sigurisë kombëtare. Ajo që është me rëndësi është që bashkëpunimi mes Kosovës, institucioneve të Kosovës dhe NATO-s duhet të rritet e të profilizohet në kuptimin e një protokolli të ri operacional me NATO-n, që është i domosdoshëm. Ndërkaq pjesa e sigurisë njerëzore apo sigurisë së brendshme, vazhdon të ketë sfida dhe rreziqe të ndryshme, prej komunikacionit, pra rreziqeve dhe sigurisë në komunikacion, e që ka neglizhencë të shtuar qeveritare në këtë pjesë, e deri në numrat apo statistikat e krimeve të lehta, për të cilat qytetarët shpesh ndihen të pasigurt sepse, tekefundit, siguria është edhe ndjenjë dhe jo vetëm aspekt fizik", tha ai.

Në një intervistë për Ekonomia Online, Ramadani deklaroi se ndër kërcënimet kryesore për sigurinë e Kosovës janë ndikimi rus dhe serb, lufta hibride, si dhe krimi i organizuar. "Mungesa e stabilitetit institucional është pjesa kryesore me të cilën sot përballet Kosova, tash e një vit e gjysmë ose gati dy vjet, sfidat e sigurisë rajonale, pra kërcënimet e vazhdueshme të Serbisë, influenca ruse dhe serbe, përmes prokseve brenda Kosovës, lufta hibride e cila po vazhdon edhe më tutje me manipulim të madh të masave, me propagandë çnjerëzore edhe brenda Kosovës dhe jo vetëm në raport me Kosovën, sikurse edhe krimi i organizuar dhe korrupsioni, që tashmë edhe me raportet e shteteve të Departamentit të Shtetit Amerikan, janë identifikuar si probleme serioze qeveritare në Kosovë", tha ai.



Kurse ka shtuar se siguria kombëtare e Kosovës rrezikohet në momentin kur nuk ka institucione stabile dhe funksionale. "Absolutisht, jostabiliteti institucional është një prej bazave të rreziqeve të sigurisë kombëtare që vjen në Kosovë, sikurse kudo nëpër botë që ndodh. Kosova është shtet i ri, i brishtë edhe më tutje dhe sado që ka periudhë që për një dekadë ka funksionuar me institucione stabile, në dy vitet e fundit tashmë jemi në ballafaqim të një jostabiliteti institucional, i cili është thelbi i sigurisë kombëtare, respektivisht siguria kombëtare e Kosovës rrezikohet kur nuk ka institucione stabile dhe funksionale", deklaroi ai.

Kurse sa iu përket planifikimeve për reduktimin e trupave të KFOR-it në Kosovë, Ramadani theksoi se e rëndësishme është që reduktimi i këtyre të fundit të lidhet me fuqizimin e institucioneve të sigurisë së Kosovës.

## Haradinaj: Nëse opozita më propozon, do ta shqyrtoja kandidaturën për president

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Ramush Haradinaj nga Aleanca tha se do ta shqyrtonte mundësinë e kandidimit për president të vendit nëse kjo mundësi do të vinte si opsion nga opozita. "Nëse opozita do të më kandidonte, do ta shqyrtoja mundësinë e kandidaturës", tha ai në një deklaratë për gazetarët. Haradinaj përmendi se vendi është në "vështirësi të mëdha". "Kosova është në sfida të mëdha, në vështirësi të mëdha. Do ta shqyrtoja pra, nëse opozita më propozon në rast të një gare për president në seancë. Do ta shqyrtoja a të kandidoj a jo", tha ai. "Ju e dini, unë s'kam qenë kandidat për president, nuk jam edhe sot", shtoi ai.






# PSE SHKURTIMI I TRUPAVE TË KFOR-it SHKON PËRTEJ ÇËSHTJES USHTARAKE?

Shkurtimi i paralajmëruar i trupave të KFOR-it në Kosovë është paraqitur si pasqyrim i një situate më të qëndrueshme të sigurisë në terren. Por, përtej këtij interpretimi zyrtar, ky zhvillim ngre pyetje për të ardhmen e sigurisë, rolin e institucioneve vendore dhe balancat politike brenda dhe jashtë vendit

**Prishtinë, 21 qershor** - Prania ushtarake ndërkombëtare në Kosovë po hyn në një fazë të re, ku shkurtimi i trupave paraqitet si reflektim i realitetit në terren.

Zyrtarët flasin për stabilitet dhe vendime të maturuara, të mbështetura në vlerësime të vazhdueshme të sigurisë. Por, në kohën kur balancat globale janë në lëvizje, edhe këto vendime marrin peshë tjetër. NATO-ja njoftoi më 12 qershor se gjatë vitit të ardhshëm do të bëjë një përshtatje graduale të pranisë së saj në Kosovë, duke reflektuar vlerësimin për një situatë të qëndrueshme të sigurisë në vend.

Sipas komandantit suprem të forcave aleate në Evropë, Alexus G. Grynkewich, ky zhvillim lidhet me rritjen e kapaciteteve të institucioneve vendore të sigurisë të cilat kanë krijuar hapësirë për zvogëlimin e misionit KFOR.

Aleanca theksoi se ndryshimet do të jenë të kujdesshme, në përputhje me kushtet në terren, dhe të kthyeshme nëse situata e kërkon.

I pyetur nga Radio Evropa e Lirë për treguesit konkretë në terren, një zyrtar i saj nuk dha detaje, duke u thirrur në natyrën konfidenciale të çështjeve operacionale dhe të inteligjencës, por nënvizoi se situata monitorohet vazhdimisht përmes mjeteve të ndryshme, në mënyrë që misioni të mbetet i përshtatshëm dhe efektiv.

Për sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, ky është një lajm i mirë. "Kur shikojmë situatën e sigurisë në Kosovë, shohim se, në përgjithësi, vitin e kaluar ajo ka vazhduar të përmirësohet. Prandaj, është një lajm i mirë për Kosovën. Kjo është edhe arsyeja përse NATO-ja në janar ka ndaluar dislokimin e forcave rezervë në Kosovë, pas dy vjetësh rotacioni të vazhdueshëm", tha Rutte në një konferencë për media këtë javë.

Në analizën e ministrit kosovar të Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, tani në detyrë, shtrirja e rendit dhe ligjit në gjithë territorin e Kosovës ka qenë një nga faktorët kyç që, sipas tij, ka ndikuar në vlerësimin e NATO-s për situatën e sigurisë.

Gjatë dy-tre vjetëve të fundit, autoritetet në Kosovë kanë mbyllur shumicën e institucioneve që funksiononin brenda sistemit të Serbisë, duke zgjeruar kontrollin në të gjithë vendin.

Paralelisht, në veri të Kosovës - ku një pjesë e madhe e popullsisë serbe vazhdon të mos i njohë institucionet e Prishtinës - autoritetet kanë marrë nën kontroll disa objekte, të cilat më pas janë vënë në funksion për bizneset shqiptare.

Maqedonci e interpreton këtë zhvillim si konsolidim të kontrollit institucional. "Kosova ka përmirësime në aspektin e sigurisë, veçanërisht pas dëbimit të grupeve terroriste dhe kriminale, të cilat kanë operuar për shumë vite në veri të vendit dhe të cilat, gjithmonë, kanë qenë kërcënim për sigurinë dhe stabilitetin e brendshëm, por edhe më gjerë", thotë ai për programin Expose të Radios Evropa e Lirë.

Që nga përfundimi i luftës në Kosovë, më 1999, veriu ishte vatër e vazhdueshme tensionesh, me struktura paralele, barrikada dhe përplasje të herëpashershme mes banorëve lokalë dhe forcave të rendit.

Një nga incidentet më të rënda ndodhi në maj të vitit 2023, kur dhjetëra pjesëtarë të KFOR-it u plagosën gjatë përleshjeve me protestues serbë, të cilët kundërshtonin vendosjen e kryetarëve shqiptarë në katër komunat veriore.

Kjo situatë çoi në dërgimin e përforcimeve shtesë nga NATO-ja.

Me mbi 4.600 trupa sot, KFOR-i pritet të reduktohet në rreth 3.500, sipas sekretarit Rutte, ndonëse mbetet e paqartë se cilat kontingjente do të preken.

Radio Evropa e Lirë kërkoi shpjegime nga Italia, Shtetet e Bashkuara dhe Hungaria - si tri kontribuueset më të mëdha në mision - por përgjigje mori vetëm nga Komanda Evropiane e Shteteve të Bashkuara, e cila paralajmëroi se kontributi amerikan do të përshtatet në përputhje me planin e NATO-s.

"Komanda Evropiane e SHBA-së do të bëjë një përshtatje të kontributit amerikan në KFOR - në faza dhe të bazuar në vlerësim të rrezikut - në përputhje me rishikimin e udhëhequr nga Komanda Supreme e Forcave Aleate në Evropë", tha një zyrtar i kësaj komande për Radion Evropa e Lirë.

Prania amerikane në KFOR konsiderohet thelbësore, pasi i jep misionit peshë politike, kapacitete shtesë ushtarake dhe efekt të fortë parandalues.

Ish-ambasadori amerikan në NATO, Douglas Lute, i cili ka komanduar Brigadën Shumëkombëshe Lindje në Kosovë në vitin 2002, beson se vendimi i Komandës Evropiane të SHBA-së është rezultat i një vlerësimi të kujdesshëm të kushteve në terren dhe jo sinjal i tërheqjes.

Sipas tij, KFOR-i mbetet një mision thellësisht shumëkombësh, ku balanca e



kontributeve mes SHBA-së dhe aleatëve evropianë është thelbësore për efektivitetin e tij. “SHBA-ja ka qenë gjithmonë - siç e thotë edhe NATO-ja - një nga vendet kornizë në KFOR. Që nga fillimi, ajo ka ofruar kapacitete që të tjerët nuk mund t’i sigurojnë, si: shërbime mjekësore të nivelit të lartë dhe aftësi për lëvizje ajrore me helikopterë. Prandaj, kontributi amerikan në KFOR është i rëndësishëm, por jo i vetëm dhe as dominues”, thotë Lute për Exposenë.

Aktualisht, Shtetet e Bashkuara kanë rreth 590 ushtarë të dislokuar në kuadër të KFOR-it - një ulje e ndjeshme krahasuar me mbi 5.000 trupat e vendosura në vitin 1999, kur misioni u krijua pas përfundimit të luftës.

Debati për rishikimin e mundshëm të kësaj pranie nisi qysh në fillim të vitit të kaluar, kur sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, gjatë një vizite në Varshavë, paralajmëroi se prania ushtarake e SHBA-së në Evropë mund të rishikohet dhe eventualisht zvogëlohet, në varësi të prioriteteve strategjike dhe kërcënimeve globale.

Në fillim të majit, Pentagoni njoftoi tërheqjen e 5.000 trupave amerikane nga Gjermania brenda 6 deri në 12 muajve të ardhshëm, ndërsa presidenti amerikan Donald Trump nuk e përjashtoi as mundësinë e reduktimeve në Spanjë dhe Itali.

Për ministrin në detyrë, Maqedonci, Policia e Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës janë të mirëpërgatitura për të garantuar sigurinë dhe për të mbrojtur çdo pjesë të territorit të vendit.

Megjithatë, ai thekson se prania e amerikanëve në KFOR mbetet jetike për paqen dhe sigurinë. “Përveç KFOR-it, duhet theksuar se Forca e Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes kanë një bashkëpunim shumë të ngushtë me SHBA-në. Ka një prani të konsiderueshme amerikane brenda reparteve tona, aktiviteteve dhe punës së përditshme, por prezenca në KFOR mbetet e domosdoshme”, thotë ai.

Në këtë rrjedhë zhvillimesh, debati nuk mund të shihet i ndarë nga një kufizim i vjetër politik që ende përcakton rolin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në veri.

Ai buron nga një zotim i vitit 2013 - i formalizuar atëkohë nga kryeministri Hashim Thaçi, përmes një letre drejtuar NATO-s - sipas të cilit dislokimi i FSK-së në veri mund të bëhet vetëm me pëlqimin paraprak të KFOR-it.

Po, si mund ta ndikojë reduktimi i paralajmëruar i KFOR-it këtë situatë?

Maqedonci vlerëson se ky zotim nuk është dashur të bëhet, duke argumentuar se FSK-ja - me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës - ka mandat të veprojë në të gjithë territorin e vendit. Sipas tij, kjo çështje duhet të diskutohet me NATO-n. “Për ne është e rëndësishme që çdo pjesë e Kosovës të ketë siguri. Besoj se, jo vetëm për çështjen e veriut, por me NATO-n duhet të diskutojmë edhe për çështje të tjera që lidhen me bartjen graduale të kompetencave te Forca e Sigurisë së Kosovës në aspektin e mbrojtjes”, thotë Maqedonci.

I pyetur nga Radio Evropa e Lirë nëse reduktimi i paralajmëruar i KFOR-it ndryshon mënyrën e koordinimit me institucionet e sigurisë në Kosovë, një zyrtar i NATO-s tha se procesi i “optimizimit” nuk prek marrëveshjet ekzistuese të bashkëpunimit me autoritetet vendore.

Ai shtoi se dislokimi i FSK-së në veri mbetet i kushtëzuar nga marrëveshjet aktuale dhe miratimi i komandantit të KFOR-it.

KFOR-i nuk iu përgjigj kërkesës së Radios Evropa e Lirë për koment.

Lidhur me këtë çështje, gjenerali i pensionuar amerikan, Douglas Lute, thotë se NATO-ja dhe autoritetet e Kosovës janë në pozicionin më të mirë për të gjykuar nëse marrëveshja ka ende kuptim ose jo. “Kam besim se komanda e NATO-s në Prishtinë po e ndjek nga afër situatën, në bashkëpunim me autoritetet e Kosovës, dhe KFOR-i nuk ka gjasa të marrë përsipër rreziqe të panevojshme”, sipas tij.

Lute shton se, në këtë fazë, prioriteti kryesor i Kosovës duhet të jetë politik, e jo ushtarak.

Ai thekson nevojën për formimin e një qeverie gjithëpërfshirëse që përfaqëson të gjithë qytetarët e Kosovës, duke e lidhur këtë edhe me qëllimin fillestar të KFOR-it dhe Rezolutës 1244 të OKB-së për një Kosovë ku sundon rendi, ligji dhe bashkëjetesa ndëretnike. “Sot në Kosovë, politika ka më shumë peshë se siguria. Gjendja e sigurisë është e mjaftueshme për të mundësuar përparim politik, prandaj pritet që, pas zgjedhjeve të fundit, parlamenti dhe qeveria të punojnë së bashku për ta çuar vendin përpara. Është koha për përparim politik”, thotë ai.

Pavarësisht se Kosova e sheh Serbinë si rrezikun kryesor për sigurinë - një perceptim i ushqyer edhe nga incidente si ai në Banjskë - Lute nuk sheh asnjë skenar të afërt për ndërhyrje ushtarake.

Përkundrazi, ai e zhvendos debatin larg kufijve dhe e sjell brenda shtetit, sidomos te forcimi i sundimit të ligjit dhe qeverisja.



## Pamje shqetësuese nga Badovci, ndotja kërcënon një nga burimet kryesore të ujit në Kosovë

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Organizata "Ta pastrojmë Kosovën" ka ngritur shqetësimin për gjendjen e krijuar pranë digës së Liqenit të Badovcit ku, sipas saj, zona është shndërruar sërish në vendgrumbullim mbeturinash. Në një postim në "Facebook", organizata thekson se më 22 mars, në Ditën Botërore të Ujit, në këtë zonë ishte organizuar një aksion pastrimi me pjesëmarrjen e vullnetarëve, institucioneve, organizatave, medieve dhe qytetarëve, gjatë të cilit ishin larguar sasi të mëdha mbeturinash. Megjithatë, sipas organizatës, gjendja sot është përsëri alarmante. "Pamjet flasin vetë", thuhet në reagim, ku theksohet se problemi nuk mund të zgjidhet vetëm me aksione vullnetare.
Organizata kërkon masa urgjente nga institucionet përgjegjëse, përfshirë kontroll më të madh, parandalim të ndotjes, ndëshkim për ndotësit dhe zgjidhje të qëndrueshme për zonën.
"Ta pastrojmë Kosovën" paralajmëron një aksion të ri pastrimi, por thekson se vullnetarët nuk mund të



zëvendësojnë përgjegjësinë institucionale.

# PROTESTAT NË TIRANË, RAMA: LËRENI ALBIN KURTIN JASHTË KËSAJ ÇORBE TË NEVERITSHME

TIRANË, 21 QERSHOR - Kryeministri Edi Rama ka reaguar sërish në rrjetet sociale sa i takon protestës masive që u zhvillua të shtunën, më 20 qershor, në kryeqytet. Duke iu referuar postimit të bërë nga një qytetare, ai shkruan se shqiptarët e Maqedonisë së Veriut nuk janë diasporë, por qytetarë të një shteti fqinj, si pjesë shtetformuese së bashku me maqedonasit. Sipas tij, e njëjta gjë vlen edhe për shqiptarët e Kosovës, pasi ata kanë shtetin e tyre të pavarur.
Kreu i qeverisë thekson se paraqitja e tyre në Tiranë si "diasporë" dhe përdorimi i flamujve kombëtarë në këtë mënyrë dëmton imazhin e shqiptarëve në rajon.
Rama përmendi edhe përdorimin e flamurit të UÇK-së gjatë protestave në Tiranë, duke e cilësuar këtë si një keqpërdorim të simbolit të luftës së Kosovës. "Kur ushtarët e verbër të karvaneve politike nga Prishtina e Tetova paraqiten në Tiranë si "diasporë", me flamuj kombëtarë që bëhen dekor i një farse të tillë dhe me plisa të bardhë që nxihen prej një marreje si kjo, ata janë thjesht viktima të zellshme që nuk ia bëjnë dot vetes një pyetje të thjeshtë: Brengoset apo gëzohet kush i do shqiptarët në sherr e në rrëmujë, kur e sheh këtë "diasporë" të Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës të turret si një hordhi pushtuese mbi kuaj me katër rrota drejt Tiranës, për të rrëzuar qeverinë e Shqipërisë?", shkruan kryeministri në Facebook.
Në fund të postimit, Rama sqaron se reagimi i tij nuk lidhet me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. "Dhe mos të spekulojë askush duke e lidhur këtë shënim me emrin e kryeministrit të Kosovës, sepse



kurrësesi nuk mund ta bëj e as ta nënkuptoj në asnjë rrethanë, përgjegjës, për asnjë prej sallahanave të Vetëvendosjes që janë përfshirë në këtë çorbë dreqërish. Nuk e them këtë hiçasfare për një larje protokollare goje, por sepse e di mirë që çdo çadër e gjerë politike mban edhe sallahanat e vet dhe do të fyeja inteligjencën e Albinit po të mendoja se ai gjykon si ata. Kështu që lëreni Albin Kurtin jashtë kësaj çorbe të neveritshme", nënvizon ai.

# MABCO RIKTHEHET NË KANTIER, PACOLLI PARALAJMËRON VAZHDIMIN E PUNIMEVE NË AEROPORTIN E VLORËS



PRISHTINË, 21 QERSHOR - Afaristi Behgjet Pacolli ka bërë me dije se të hënën MABCO së bashku me mbi 200 specialistë të nënkontraktorëve të saj do t'i rifillojë punimet në kantierin e Aeroportit të Vlorës. Ai ka thënë se ky veprim do të ndërmerret në përputhje të plotë me vendimin e Gjykatës së Lartë dhe me vendimin e Asamblesë së Aksionarëve të VIA-s të datës 18/06/2026 si dhe në respekt të kërkesës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe qëndrimit të shprehur publikisht nga kryeministri Edi Rama, se Aeroporti i Vlorës nuk duhet të bjerë pre e interesave të ngushta apo veprimeve të paligjshme të askujt, por të përfundojë sa më parë dhe të hapet për operim.
"Pas një bllokade disamujore dhe përpjekjeve të personave që kanë vepruar në mënyrë të paligjshme, pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë tagër, punimet u penguan në mënyrë të dhunshme. Këta persona, madje me mbështetjen e strukturave të Policisë së Shtetit, ndërprenë aktivitetin në kantier dhe sekuestruan në mënyrë arbitrare pajisje, mjete pune dhe makineri private në pronësi të nënkontraktorëve. Rifillimi i punimeve shënon rikthimin e ligjshmërisë dhe respektimin e vendimeve të institucioneve juridike dhe atyre kompetente, duke i hapur rrugë vazhdimit dhe përfundimin të punimeve në një nga projektet më të rëndësishme infrastrukturore të vendit. Mabco kërkon drejtësi, transparencë dhe legjitimitet, dhe si gjithmonë mbështetjen konstruktive të institucioneve dhe çdokujt në mënyrë që aeroporti të hapet sa më shpejt!", ka thënë Pacolli përmes një postimi në "Facebook".

## Mbi 19 mijë maturantë iu nënshtruan testit të maturës, disa raste përjashtimi për shkak të telefonit

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Mbi 19 mijë maturantë i janë nënshtruar të shtunën provimit të maturës në 152 qendra të testimit në gjithë vendin. Ky test mat njohuritë e arsimit parauniversitar deri në klasën e 12-të. Gjatë ditës u raportua se janë shpërndarë përmes internetit pyetjet e testit.
Pak orë pas përfundimit të provimit, për mbarëvajtjen e gjithë procesit, foli Fatmir Elezi nga Ministria e Arsimit, i cili tha se procesi ka shkuar mirë, derisa përmendi disa raste të përjashtimit për shkak të përdorimit të telefonit.
Ky test është zhvilluar brenda një dite për të gjitha lëndët dhe për të gjithë kandidatët, përderisa përmban 100 kërkesa, përkatësisht nga 25 kërkesa për secilën prej katër lëndëve: gjuhën amtare, angleze, matematikën dhe një lëndë zgjedhore të përzgjedhur nga vetë kandidati/ja.



# EKONOMISTËT THONË SE INFLACIONI I LARTË PO RËNDON BIZNESET DHE PO VARFËRON QYTETARËT



PRISHTINË, 21 QERSHOR - Njohës të çështjeve të ekonomisë kanë vlerësuar se inflacioni i lartë është duke e goditur standardin e jetesës dhe duke rënduar pozitën e bizneseve në Kosovë. Sipas tyre, rritja e çmimeve po e ul fuqinë blerëse të qytetarëve, ndërsa mungesa e investimeve prodhuese dhe paqëndrueshmëria politike po pengojnë zhvillimin ekonomik afatgjatë të vendit.

Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka thënë se e alarmet për inflacionin dhe problemet ekonomike po mbesin në hije të krizës politike dhe debatit për pushtetin. "Shqetësues është fakti që rekomandimet që vijnë, qoftë nga ekspertë vendorë, qoftë nga institucionet ndërkombëtare, që nuk shkojnë në favor të politikës ditore, ato ose heshtën, ose kundërshtohen pa argumente. Në këtë drejtim, sa i përket efektit negativ të rritjes së inflacionit në 7.5% në vitin 2026, ne kemi alarmuar që është vërtetë një situatë shqetësuese", ka thënë ai për EO.

Ai ka shtuar se raportet ndërkombëtare kanë ngritur shqetësime edhe për korrupsionin, punësimet politike dhe lirinë e mediave. "Nuk është vetëm problemi i inflacionit që ka ardhur si alarm nga Bashkimi Evropian. Kanë qenë raporte të tjera që kanë të bëjnë me punësimet politike, me sulmet dhe mungesën e lirisë së mediave, por mbi të gjitha, mbi korrupsionin dhe tenderomaninë që është shndërruar në sëmundje kancerogjene të Kosovës. Prandaj vërtetë është koha kur duhet sa më shpejt, është e mundur Kosova të ketë stabilitet politik. Stabilitet politik i cili është i vështirë të arrihet me këtë mentalitet të politikës, sepse në Kosovë nuk fitohen si duket zgjedhjet për të qeverisur, por për të sunduar", ka thënë Gërxhaliu.

Edhe eksperti i ekonomisë, Ismet Mulaj, ka vlerësuar se rritja e inflacionit po i varfëron qytetarët dhe po ndikon negativisht te bizneset. "Natyrisht kjo i varfëron qytetarët. I varfëron qytetarët, natyrisht i varfëron edhe bizneset, për shkak se qytetarët konsumojnë më pak, blejnë më pak. Ose, qytetarët nuk, nuk investojnë. Përderisa nuk investojnë domethënë, për të gjithë atë kontingjent financiar që e kanë e ruajnë për konsum për shkak si të thuhet, domethënë për shkak se janë nevoja elementare ato, atëherë biznesi dekurajohet. Natyrisht ka biznese sot, investimet më të mëdha që i realizojnë domethënë kosovarët në investime kapitale janë në Shqipëri. Rreth 600 deri 700 milionë euro shqiptarët e Kosovës kanë investuar në Shqipëri", ka thënë Mulaj për EO.

Ai ka thënë se Kosova duhet të fokusohet në projekte të mëdha zhvillimore që do të nxisnin investimet dhe rritjen ekonomike.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës në prill të vitit 2026, Kosova ka shënuar nivelin më të lartë të inflacionit në tri vitet e fundit, duke arritur në 7.5 për qind, ndërsa në maj inflacioni është regjistruar në 6.8 për qind. Sipas të dhënave, norma e inflacionit në Kosovë mbetet dukshëm më e lartë se mesatarja e Bashkimit Evropian, e cila është rreth 3.2 për qind.

# TRANGULLI I KOSOVËS PO FITON TREGUN EVROPIAN

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Nga serrat e Rahovecit drejt tavolinave evropiane. Me çmim më të lartë, cilësi më të mirë dhe kërkesë në rritje, trangulli i Kosovës po dëshmon se është një nga kulturat më fitimprurëse për fermerët dhe një produkt që po fiton besimin e tregjeve ndërkombëtare.

Çmimi më i lartë krahasuar me vitin e kaluar, rendimenti i mirë dhe kërkesa gjithnjë në rritje nga tregjet evropiane po i motivojnë fermerët që të zgjerojnë kultivimin e trangullit. Kjo kulturë vazhdon të mbetet ndër perimet më fitimprurëse në vend, ndërsa suksesi i saj lidhet ngushtë me prodhimin cilësor dhe plasmanin e sigurt.

Aziz Krasniqi nga fshati Radostë i komunës së Rahovecit kultivon 8 hektarë tokë me perime dhe kultura kungullore. Nga kjo sipërfaqe, 80 ari janë të mbuluara me serra, ku këtë vit gjysmën e tyre e ka mbjellë me trangull. Ai pret rendiment të lartë dhe prodhim cilësor.



Sa i përket sëmundjeve që prekin këtë kulturë, Krasniqi thotë se këtë vit nuk ka pasur probleme serioze. Madje, duke përdorur fidanë të shartuar, ka arritur të shmangë edhe dëmtuesit që e kishin shqetësuar në vitet e kaluara.

Ai shton se shitja është e garantuar dhe është i kënaqur edhe me çmimin, i cili është më i favorshëm se një vit më parë.

Trangulli renditet ndër tri kulturat perimore më të rëndësishme ekonomike në Kosovë. Këtë e thekson agronomi Besim Sahiti, i cili nënvizon se zgjerimi i sipërfaqeve me perime varet në masë të madhe nga sigurimi i tregut për produktin.

Sipas tij, për të arritur një plasman të qëndrueshëm, fermerët duhet të menaxhojnë në mënyrë profesionale parcelat e tyre, duke filluar nga përzgjedhja e fidanëve, skemat e duhura të plehërimit dhe zbatimi i masave mbrojtëse ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve.

Për shkak të ciklit të shkurtër të kultivimit, trangulli kërkon kujdes të veçantë në ushqimin e bimës dhe mbrojtjen fitosanitare.

Sahiti thotë se sëmundjet që e prekin më së shumti këtë kulturë janë vrugu, hiri i kungulloreve dhe sëmundjet e rrënjës. Ndërsa nga dëmtuesit më problematikë ai veçon tripsin, morrin e gjetheve, merimangën dhe nematodin, një dëmtues që ka filluar të shfaqet vitet e fundit në Kosovë.

Duke marrë parasysh kërkesën në treg, çmimet dhe ciklin e shkurtër të prodhimit, Sahiti vlerëson se kultivimi i trangullit është një veprimtari shumë fitimprurëse.

Emrush Taqi nga fshati Qifllak i komunës së Rahovecit thotë se rendimenti dhe cilësia janë më të mira se vitin e kaluar. "Jemi të kënaqur me çmimin, pasi këtë vit është më i lartë se vitin e kaluar. Si veprimtari është fitimprurëse, por problem për ne mbetet fuqia punëtore", thotë Taqi.

Ndërkohë, Feim Rexhepi, drejtues i pikës grumbulluese në Xërxë të Rahovecit, tregon se këtë vit pritet të grumbullohen rreth 1,500 tonë trangull, dyfish më shumë se vitin e kaluar.

Ai shpjegon se bashkëpunimi me fermerët zhvillohet në mënyrë profesionale, ndërsa seleksionimi i produktit realizohet sipas standardeve dhe metodave bashkëkohore ndërkombëtare. Sipas Rexhepit, edhe çmimi i blerjes është më i lartë krahasuar me vitin e kaluar. Trangulli i prodhuar në Kosovë, i grumbulluar në këtë qendër, eksportohet kryesisht në vendet evropiane.

Ai thekson se blerësit nga Evropa janë gjithnjë e më të kënaqur me cilësinë e produkteve, gjë që po reflektohet me rritjen e vazhdueshme të kërkesës nga viti në vit. (RTK)

## Kurti: Do ta nisim programin 'Superpuna për Gratë', që garanton pagën minimale për gjashtë muaj

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka bërë me dije se Qeveria e Kosovës do të vazhdojë ta zgjerojë mbështetjen për gratë në biznes dhe në tregun e punës.

Në 'Facebook', pas konferencës "Gratë në Biznes - She Rises 2026", ku morën pjesë rreth 300 gra nga fusha e ndërmarrësisë, institucionet dhe organizatat vendore e ndërkombëtare, Kurti tha se një grua ekonomikisht e pavarur është shtyllë e një familjeje të fortë, e një shoqërie përparimtare dhe e një ekonomie të zhvilluar.

Ai theksoi se qeveria është e përkushtuar që mbështetja për gratë të mos mbetet vetëm në nivel deklarativ, por të përkthehet në programe konkrete, përfshirë subvencionimin e drejtpërdrejtë, lehtësimin e qasjes në financa, si dhe themelimin e Divizionit për Gratë Ndërmarrëse në agjencinë që po krijohet nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit.

Sipas Kurtit, në kuadër të mbështetjes së punësimit dhe zhvillimit ekonomik do të nisë edhe programi "Superpuna për Gratë", i cili do të garantojë pagën minimale për gjashtë muaj për gratë që hyjnë ose rikthehen në tregun e punës. Ai tha se programi do të krijojë përfitime si për punëmarrëset ashtu edhe për bizneset.



# PANAIRI NË PRANGA



Berat ARMAGEDONI

*Lexues të dashur,*

**Fillimisht ju bëj me dije se nuk më erdhi lehtë ta shkruaj këtë titull e as ta dëgjoj këtë tingull të këtyre tri fjalëve për ngjarjen vjetore më të madhe të librit në Kosovë. Por meqë në bark më është bërë bas, u detyrova të shkruaj prej zemrës së plastë dhe me shkas. Ndonjë të sharë nga ndokush do ta ha, patjetër, po punë e madhe, se nëna ime, edhe pse ka lindur dhjetë fëmijë, kurrë s'ka mbetur shtatzënë nga të sharat, por nga të q... nga im atë, Rasimi**

Që njëzet e gjashtë edicione, Shoqata e Botuesve e Kosovës (ShBK), e cila ka njëzet e shtatë vjet jetë në legalitet, një javë para organizimit të edicionit të ri të panairit, e njofton publikun e ngushtë dhe të gjerë, nëpërmjet medieve të llojeve të ndryshme dhe nëpërmjet rrjeteve sociale të llojeve të ndryshme e nëpërmjet gojëve e zërave të ndryshëm, se në këtë edicion do të marrin pjesë rreth njëqind botues, se do të paraqiten rreth dy mijë botime të reja, se do ta vizitojnë rreth tridhjetë mijë vizitorë. Nuk e ka ndryshuar statistikën e botimeve në asnjë vit edhe pse vetëm në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut rreth 7 000 libra botohen brenda një viti. More asnjë fjalë se ka ndryshuar nga ato të mëparshmet! Pra, dy a tre më pak a dy a tre më shumë botues se njëqind dhe dhjetë më pak a dhjetë më shumë botime të reja se dy mijë. Nuk e ka ndryshuar këtë njoftim në asnjë vit. As vendin, as karakterin, as lëvdatat, as motot frazeologjike, pa shije e pa kreativitet. Pllakatet, po. Numrat e edicionit, po. Disa figura publike e jopublike të Kosovës, që përçajnë dhe sundojnë e që janë me njëri-tjetrin si ujku me dhinë, po. Shkrimtarë të huaj na merr malli të shohim në panair. Një sa për farë, shkrimtar i shtëpisë së ish-shefit, sivjet erdhi, u nderua prej ShBK-së me njëfarë çmimi kryesor. Çmim panairi me juri "(ndër)"kombëtare dhe arritje kulmore, kryesisht me juri panairesh. Ka çfarë të shkruhet shumë, po sa shkruaj unë për këtë punë ju s'keni kohë të lexoni në këtë të diel me diell. Por, do "sene" medoemos që duhen thënë qoftë me hir, qoftë me pahir.

ShBK s'e ka ndryshuar as lakminë për të marrë para nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), as mbledhjen e taksave nga botuesit, për të cilët, kushdo që bën analizë të shpenzimeve, e kupton se ajo është gjobë. Pra, ShBK, edhe pse ka emër shoqate të botuesve, nuk i ndihmon botuesit. I ndëshkon dhe veprat e autorëve të tyre i nëpërkëmb. Djersën ua "nxjerrë" nga trupi dhe gjakun ua "thithë" si pambuku. Edhe mua nja pesë gjashtë vjet po ama, ma jo! Zgjerohet nga mundi i tyre dhe e trashë pasurinë e patundshme nga xhepat e tyre. Edhe pse ka shumë para, sivjet Shoqata kishte harruar t'i përkujtojë shkrimtarët në përvjetorët e lindjes e të vdekjes. Një fjalë për asnjë shkrimtar vendor e botëror të vdekur s'e shkroi. Punë e madhe, kanë vdekur dhe kanë shkuar për "lesh". I gjalli me të gjallin, i vdekuri me të vdekurin. Një poster për ta për asnjë postiere (media) s'e çoi te publiku. Një fjalë s'e shkroi as për Qosjen. As për Kadarenë. Një tryezë të vogël do të duhej për këta "rivalë", se panairet me ta kanë pasur jehonë. Qosja tepihun e panairit e ka shkelur deri vjet. I ka nderuar botuesit, lexuesit dhe panairin. As për këta dy kolosë e as për asnjë kockë letrare kombëtare asnjë fjalë prej ShBK-së. Madje edhe aktivitetet e shtëpive botuese, përurimet e librave, ShBK përpiqet t'i shesë se janë të saj. Ama, ato s'janë të saj.

Para se të shtrojmë dhe analizojmë shumë çështje të tjera të ShBK-së dhe rreth saj dhe organizimit të panairit prej saj, e hapim gojën dhe pyesim: Kush është ai anëtar, ai person i angazhuar nga ShBK, që i numëron vizitorët dhe na jep këtë statistikë: 30 000 mijë vizitorë për pesë ditë? Si i numëron ai/ajo vizitorët? Me gishta, me sy, me laps, me kalkulator... me çfarë? Me ëndrra? Me parashikime? Nëpërmjet prerjes së biletave?! Jo, se ShBK nuk pret bileta siç pret para nga institucionet dhe nga botuesit çdo vit. Kënaqësia e saj më e madhe është kur në secilin edicion e njofton publikun se "hyrja është falas". Sa e arritur e madhe kjo! E përsëritshme dhe e bezdisshme! Kur vite më parë e lexoja këtë fjali prej saj, organizatorëve u shkruaja dhe u thosha: hiqeni! Mos i trembni vizitorët, se një ditë do të mbesni edhe pa ta dhe do të detyroheni t'u jepni ujë ("Rugove" ka dhënë dhe po jep kompania "Ujë Rugove", bukë, para, edhe mirënjohje për t'jua mbushur hapësirën dhe për t'ju përshëndetur me zor). Dhe kjo ditë, fatkeqësisht, po vjen dhe, fatkeqësisht, ditë edhe më të këqija për librin fizik dhe për atë elektronik do të vijnë po qe se edhe më tutje ShBK nuk bën analiza serioze dhe po qe se nuk sillet me botues dhe lexues seriozisht. A ka ajo ShBK ndonjë njeri që s'pajtohet me tjetrin, me shefin?! Ndonjë burrë që ia kthe fjalën burrit? Ndonjë grua që ia kthe fjalën gruas?! Ndonjëri ndokujt?!

Për edicionet e kaluara të panairit kam shkruar shpesh dhe kam shprehur shumë pakënaqësi publikisht dhe ua kam shprehur organizatorëve edhe gojarisht. Reagimet e tyre të dikurshme s'i kam marrë nëpërmjet shkrimeve e as afër zemrës, por nëpërmjet ofendimeve, kërcënimeve (kam bërë denoncim në polici) dhe përpjekjes për nëpërkëmbje kur me shtëpinë botuese "Armagedoni" merrja pjesë e "ngaja" herë në një qoshe, herë në një tjetër; herë në "purgator" me furtunë e me shi jashtë, herë në "ferr" me përballje me disa "luciferë" përbrenda që kundërmonin erë e që njëherë e një kohë redaktorit të kulturës të shtojës për kulturë të "Kohës Ditore" ia bllokonin hundët e disa tipa pastaj dilnin në rrugë t'ia zhbllokonin me grushte veç pse, ato dy fjalë, për keqorganizim të panairit, nuk ia kishte thënë në vesh e që do të mund të ishte pajisur me ndonjë çmim panairi, por ia kishte shprehur në gazetë të shtypur publikisht. Pavarësisht prej rrahjes së teneqesë para veshëve të shurdhër të anëtarëve të ShBK-së nga disa dashamirës të librit dhe aktiviteteve kulturore, asnjë masë për përmirësim të panairit nuk e kanë ndërmarrë kurrë organizatorët që janë familjarë dhe që, për organizimin e panairit kështu si e bëjnë, marrin mijëra euro që 26 edicione nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe nga taksat që mbledhin nga botuesit para dhe pas pjesëmarrjes.

S'di pse institucionet dhe zyrtarët ua kanë tuten hakërrimave të ShBK-së e ia "shprehin" respektin nëpërmjet mbështetjes së majme financiare, kur anëtarët e "shumtë" të saj nuk shprehin mbështetje dhe respekt për




botuesit dhe lexuesit. Ata pak anëtarë të kësaj shoqate, ata kryesorët, më kryesorët, më të mëdhenjtë, të plotfuqishmit financiarisht, librin e konsiderojnë vetëm para dhe po për ta, disa "analistë të panaireve, të librave e të shtëpive botuese", që sigurisht dinë pak për të zezat e tyre, ngarendin t'i quajnë seriozë e të thonë, pa pasur njohuri për Ligjin për Libër dhe Veprimtari Botuese e Ligjin për Biblioteka, se në Kosovë ka autorë që botojnë libra nga njëzet e kusur mijë copë dhe i shesin nga njëzet e kusur euro dhe i botojnë privat, pra pa botues. Jo, s'i botojnë privat, se njëzet e kusur mijë libra nuk mund të shiten dorë më dorë. Librat e tyre kanë botues dhe kanë sukses dhe gjenden nëpër librari, jo nëpër magazina. Nëse ata/ato autorë/e kanë shitur kaq shumë libra, edhe janë të rrallë, edhe s'mund ta arrijë sekush suksesin e tyre edhe nëse lind edhe një herë tjetër dhe që nga shkolla fillore ia nis të shkruajë vargje, fjalë, emocione e ku di tjetër. Në mundshi, bëhuni ju të suksesshëm në fushën e letërsisë siç janë bërë disa në fusha të tjera. Portat e Panairit, për matje të fuqisë e të ndikimit, të hapura i keni te Pallati i Rinisë!

Më tutje, gjoba.

Organizatorët e panairit të librit disave u marrin 30 euro për një metër katror, disa të tjerëve 35, varësisht se cilën sallë zgjedhin të ekspozojnë libra, atë të "myslimanëve", atë të "katolikëve, myslimanëve e ortodoksëve bashkë etj", apo atë skaj shefave kryesorë që, përpos që është e kushtueshme, është edhe e pamundshme. Vendet kryesore, për babë e bir. Por, edhe pse Panairi i Librit në Prishtinë organizohet që 26 edicione, edhe pse që rreth njëzet e shtatë vjet janë hapur qindra shtëpi botuese në Kosovë (mbi treqind), numri i botuesve pjesëmarrës në panair po bie çdo vit e numri i anëtarëve të ShBK-së nuk po rritet asnjë ditë. Tash, për ta mbushur hapësirën e panairit me libra dhe me njerëz, ftesa për pjesëmarrje po u bëhen edhe shitësve të librave të vjetër e të përdorur në dy sheshet e Prishtinës, të cilëve, kur panairi kishte shumë botues, ata të shkretët veç vinin i "kullotnin" sytë nëpër libra, se pjesëmarrjen e kishin të pamundur. Kështu që, për shkak të gjendjes së tashme, njoftimeve e statistikave të pasakta e pakënaqësive të shumta të botuesve që i shprehën edhe në portale lajmesh e kronika televizionesh këto katër ditë, ShBK do të duhej të tkurrej përditë. Dikush aty duhet të japë llogari. Dikush aty ka përgjegjësi. Dikush aty duhet të flasë. Duhet të thotë se, përpos rënies së interesimit të botuesve e të lexuesve për pjesëmarrje dhe vizita, janë shkurtuar edhe ditët e panairit. Na ishin gjashtë, janë bërë pesë. Në të ardhmen mund të shkurtohet edhe për një dhe pas një kohe, kur në Panairin e Librit në Prishtinë do të marrin pjesë jo rreth njëqind, por rreth dhjetë botues, portave të panairit do t'u vihen prangat krejt. Nuk do t'ua vë shteti, por mileti, i cili, kur shkon sheh se gjysma e botuesve sivjet nuk kanë marrë pjesë, e qet këtë punë dhe e lë krejt. Nuk ia mësynë panairit të librit, por ndonjë pune të hairit.

Prandaj, lexues, ju mbani mend edhe këtë më poshtë e ata, organizatorët, sa më parë duhet të mbledhin mend po qe se duan t'i mbajnë hapur portat e panairit edhe ndonjë vit:

